

V E N D I M
Nr.457, datë 3.7.2003

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT DHE TË BASHKËPUNIMIT
“PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2003”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Memorandunit të Mirëkuptimit dhe të Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2003”, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, që, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave për nënshkrimin e këtij Memorandumi, të ndjekë zbatimin e detyrimeve që përcaktohen në të.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MEMORANDUM
MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI

“PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2003”

Sot më datë , 2003 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga zoti Ben Blushi, Ministër i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga zoti Ilirjan Celibashi, të quajtura Palë këtu dhe më poshtë, nënshkruhet ky Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi.

Palët në këtë Memorandum bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i këtij Memorandumi është angazhimi i Palëve, në përputhje me detyrimet përkatëse kushtetuese dhe ligjore respektive, për përgatitjen dhe organizimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2003.

Neni 2

Palët në këtë Memorandum veprojnë në përputhje me statusin e tyre institucional të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin tjetër. Në këtë kuptim, Këshilli i Ministrave dhe organet e varësisë, autoritetet vendore duhet të mbështesin KQZ-në në:

- Financimin e procesit zgjedhor sipas vendimeve të KQZ-së, si dhe mbështetje të menjëhershme me akte nënligjore për realizimin e procedurave të shpenzimeve buxhetore.

- Sigurimin e ambienteve të përshtatshme të punës për KZQV-të dhe qendrave të votimit sipas akteve të KQZ-së.

- Sigurimin e pajisjeve të nevojshme për punë dhe për komunikim për KZQV-të dhe qendrat e votimit (linjë telefonike, orëdi zyre të domosdoshme për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor).

- Sigurimin e ambienteve që janë në administrim të njëjësive përkatëse të qeverisjes vendore për

trajnimet që KQZ-ja do të organizojë për komisionet e KZQV-ve dhe KQV-ve. Sigurimi i këtyre ambienteve në numër dhe në ditë të realizohet sipas kalendarit të paracaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

- Angazhimi i strukturave të organeve të qeverisjes vendore për transportin e bazës materiale, dokumentacionit zgjedhor dhe të komisionerëve lokalë, si dhe mbështetjen e KQZ-së me mjete të ndryshme të transportit, mbi bazë të kërkesës së saj, nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, gjatë gjithë procesit zgjedhor.

- Caktimi i vendeve për shpalljen e listave paraprake dhe përfundimtare të zgjedhësve për çdo qendër votimi.

- Angazhimi i zyrave të gjendjes civile, sekretarëve të këshillave të bashkive e komunave (që njëkohësisht janë edhe sekretarë të KZQV-ve), si dhe punonjësve të administratës për rishikimin e listës së zgjedhësve të 24 qershorit 2001, duke u bazuar në nenin 154 pika 3 të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” dhe disponibilitetin për administrimin e rregullt të procesit zgjedhor.

- Nxjerrjen e akteve nënligjore për aspekte, të cilat lidhen me përgatitjen e listës së zgjedhësve, mbi bazë të kërkesës së KQZ-së.

Neni 3

Mbi bazën e akteve të KQZ-së, prefektët dhe administrata që ata drejtojnë, do të sigurojnë:

- realizimin e detyrave të parashikuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi në nivel lokal;
- ndjekjen e punës së zyrave të gjendjes civile në rishikimin e listës së zgjedhësve të 24 qershorit të vitit 2001 nëpërmjet regjistrit civil të shtetasve në nivel lokal.

Neni 4

Për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga ky Memorandum, Palët veprojnë në bazë të kompetencave që u njih ligji. Në këtë kuadër, Palët njohin rolin drejtues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për përgatitjen e zgjedhjeve, si dhe angazhimi i posaçëm në emër të Qeverisë, të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, për të realizuar angazhimet që burojnë nga ky Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi.

Neni 5

Ky Memorandum, hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Palët dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, 2003

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE

Ben Blushi

Ministër i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit

PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Ilirjan Celibashi

Kryetar i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve